

20252094127

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 34 paragrafit (18) të Ligjit për Arsimin e të Rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 3/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE PËR MËNYRËN E AKREDITIMIT TË OFRUESIT TË SHËRBIMIT PËR VALIDIM, SI DHE FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR AKREDITIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE PËR VALIDIM DHE DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e akreditimit të ofruesit të shërbimit për validim, si dhe forma dhe përmbajtja e formularit të kërkesës për akreditimin e ofruesve të shërbimeve për validim dhe dokumentacioni i nevojshëm.

Neni 2

Kërkesa për akreditimin e ofruesit të shërbimit për validim parashtrohet në formular me përmasa 21 cm x 29,7 cm, i cili është dhënë në Shtojcë dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Kërkesës për akreditimin e ofruesit të shërbimit për validim, dorëzohen dokumentet në vazhdim:

- aktvendim për akreditim, validim për institucionin publik për arsimin fillor ose të mesëm,
- dëshmi për veprimtarin e regjistruar,
- elaborat i institucionit,
- të dhëna për hapësirën dhe pajisjet për kualifikimin përkatës për validim,
- të dhëna për personin e punësuar/angazhuar nga radhët e personave të regjistruar në
- Katalogun e këshilltarëve të certifikuar për validim,
- të dhëna për personin e punësuar/angazhuar nga radhët e personave të regjistruar në Katalogun e vlerësuesve të certifikuar për validim, për kualifikimin përkatës,
- statut i institucionit,
- deklaratë për sigurinë për çdo vend pune në përputhje me kërkesat e kualifikimit përkatës dhe
- fletëpagesë për kryerjen e pagesës së shpenzimeve për verifikimin e përmbushjes së kushteve për akreditim në llogarinë e Qendrës për Arsimin e të Rriturve.

Neni 4

Akreditimi i ofruesit të shërbimit për akreditim, kryhet në mënyrë që verifikon përmbushjen e normativit dhe standardeve për hapësirën, pajisjet dhe kuadrin për akreditimin e institucionit për validim, përmes inspektimit të drejtpërdrejtë, gjatë të cilit kontrollohet:

- dokumentacioni i dorëzuar dhe kërkesa për akreditim,
- kushtet hapësinore dhe materiale të nevojshme për realizimin e validimit të kualifikimit përkatës dhe
- kushtet e kuadrit të nevojshme për realizimin e validimit.

Për inspektimin e përmbushjes së kushteve për akreditim, informohet Institucioni më së voni tre ditë para kryerjes së inspektimit.

Neni 5

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit të saj në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 18-13034/1
8.10.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Pr. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.

До
ЈУ Центар за образование на возрасните – Скопје

Б А Р А Њ Е
за акредитација на понудувач на услуга за валидација по јавен повик бр. _____.

1.	Назив на установата	
2.	Назив на квалификацијата	
3.	Број на Решение на акредитирана јавна установа за основно или средно образование	
4.	Директор	
5.	Адреса	
6.	Телефонски број	
7.	Адреса на е-пошта:	
8.	Име и презиме на советник/советници за валидација	
	За советниците вклучени во валидацијата да се приложи копија од: - свидетелство/диплома за завршено соодветно образование - сертификат за завршена обука за советник за валидација - биографија - договор за вршење на услуга помеѓу установата и советникот во која се дефинирани обврските, одговорностите и услови за работа	
9.	Име и презиме на проценувач/проценувачи за валидација	
	За проценувачите вклучени во валидацијата да се приложи копија од: - свидетелство/диплома за завршено соодветно образование - сертификат за завршена обука за проценувач за валидација - биографија - договор за вршење на услуга помеѓу установата и проценувачот во која се дефинирани обврските, одговорностите и услови за работа	
10.	Простор за вршење на валидација:	
	-вкупна површина (во m²)	
	-вкупен број на училници, кабинети, други простории	
	-адреса на место на спроведување	
11.	Кон барањето да се приложи следната документација:	

	- решение за акредитација за валидација на јавна установа за основно или средно образование, - доказ за регистрирана дејност, - елаборат на установата, - податоци за простор и опрема за соодветната квалификација за валидација, - податоци за вработено/ангажирано лице од редот на лицата запишани во Каталогот за сертифицирани советници за валидација, - податоци за вработено/ангажирано лице од редот на лицата запишани во Каталогот за сертифицирани проценувачи за валидација, за соодветна квалификација, - статут на установата, - изјава за безбедност за секое работно место согласно потребите на соодветната квалификација и - уплатница за извршена уплата на трошоците за проверка на исполнетоста на условите за акредитација на сметка на Центарот за образование на возрасните	
12.	Опрема:	
	- краток опис на опремата потребна за реализација на валидацијата за соодветната квалификација	
13.	Изјава од директор/овластено лице	Јас долупотпишаниот: - ја потврдувам точноста на информациите содржани во барањето, статутот и елаборатот - потврдувам дека се исполнети сите потребни стандарди и услови за реализирање на валидација - се согласувам да се врши непосреден увид во работењето на установата

Датум:

Барател: _____

(Име, презиме и потпис на директор)

(Печат на установата)